



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 110, Datë 14.05.2018

MBI

ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET KESH SH.A DHE OST SH.A, LIDHUR ME KORRIGJIMET E FATURAVE PËR SHËRBIMIN E BALANCIMIT SIPAS PARASHIKIMEVE TË AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI DHE PËRLLOGARITJEVE NGA OST SH.A TË RAKORDUARA DHE TË PRANUARA NGA PALËT PËRGJEGJËSE PËR PERIUDHËN 1 KORRIK 2016 – 31 DHJETOR 2017

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërmat “a” dhe “ë” si dhe nenit 24 pikat 1, 2, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ndryshuar; neneve 15 dhe 23, të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; në zbatim të neneve 11 dhe 12 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror; Kapitulli II, pika 2.4 dhe Kapitullin XI, pika, 2.3 të Rregullave të Përkohëshme të Tregut, miratuar me vendimin nr. 139, datë 15.08.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.05.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a., mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016 “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 619/1 Prot, datë 04.08.2017, shoqëria KESH sh.a., ka paraqitur pranë ERE-s një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së lindur mes saj dhe shoqërisë OST sh.a., si rezultat i përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga zbatimi i vendimit të ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016 “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST

sh.a, lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”.

- Kontrata për sigurimin e shërbimeve ndihmëse të balancimit të sistemit energjitik, e nënshkruar nga KESH sh.a. dhe OST sh.a., është miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 79, datë 07.06.2016, “Mbi miratimin e kontratës për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik për periudhën kohore 01.01.2016 – 30.06.2016”.
- Në vendimin e tij nr. 123, datë 16.08.2017, bordi i ERE-s vendosi: Pranimin për shqyrtim nga ERE të ankesës së paraqitur nga shoqëria KESH sh.a, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a dhe OST sh.a, lidhur me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik që rrjedh nga vendimi i bordit të ERE-s nr. 194, datë 30.12.2016, duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konform, *Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.*
- Me shkresën me nr. 551/1 Prot, datë 21.08.2017, ERE i ka dërguar palëve, subjekte të mosmarrëveshjes, vendimin e e sipërcituar dhe u ka kërkuar që në zbatim të procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të paraqesin pranë saj, brenda 7 ditëve, çdo dokumentacion që mund t'i shërbejë vendimmarrjes së ERE-s, me qëllim zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje.
- Në shkresën nr. 4480/1 Prot., datë 30.08.2017, OST sh.a., ka dërguar pranë ERE-s argumentat e tij lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi në ERE.
- Në shkresën nr. 619/3 Prot., datë 29.08.2017, kompania KESH sh.a., ka paraqitur argumentat e saj lidhur me mosmarrëveshjen, objekt gjykimi në ERE.
- Në përfundim të argumentave të dërguara nga të dyja palët në mosmarrëveshje KESH sh.a. dhe OST sh.a., ERE konstaton se, marrëdhënia mbi kapacitetin balancues, objekt konflikti mes palëve gjen rregullim në “*Kontratën për Sigurimin e Shërbimeve Ndihmëse dhe të Balancimit të Sistemit Energjitike*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 79, datë 07.06.2016. Ndërsa lidhur me problematikën mbi llogaritjen e disbalancave, ERE ka dhënë përcaktimet e saj për rregullimin e kësaj marrëdhënieje mes palëve, në Kapitullin IX – (Rregullat për Llogaritjen e Disbalancave) të “*Rregullave të Përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike*” të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 139, datë 15.08.2016.
- Në mbledhjen e Bordit të ERE të datës 28.09.2017, përfaqësues të KESH sh.a kërkuan shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit në lidhje me zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, duke deklaruar se do të negociojë me OST sh.a, për zgjidhjen me mirëkuptim të saj.
- Në shkresën me nr. 2002/1 Prot, datë 16.03.2018 protokolluar në ERE me nr. 114/6 Prot hyrës, datë 19.03.2018 të shoqërisë OST sh.a., lidhur me vijimin e komunikimit, ndër të tjera sqarohet se:
 - Prej korrikut 2016 dhe deri në hyrjen në fuqi të rregullave të “*Përkohëshme të Mekanizimit Balancues në Shqipëri*”, me hyrjen si subjekt disbalance, OSHEE

sh.a., ka patur diferenca në bilancin financiar të subjektit OST sh.a., si palë e cila është e ngarkuar nga aktet ligjore, për të administruar procesin e llogaritjeve të disbalancave e më pas dhe faturimin përkatës për pjesemarrësit e tregut, nuk është kryer në mënyrën e duhur.

- Nga muaji korrik 2016 që pas vendimit të bordit të ERE-s nr. 106, datë 29.06.2016 i cili përcaktoi se subjekti “OSHEE” sh.a. është përgjegjës për disbalancat e energjisë elektrike, janë hasur disa probleme. Llogaritja e disbalancave ndaj të gjithë subjekteve është bazuar në *Rregullat e Tregut* në fuqi duke zbatuar formulën e disbalancave pika IX.1.1 në *Rregullat e Tregut*. Ka qënë pikërisht kjo mënyrë llogaritjeje e përcaktuar në pikën IX.1.1 të vendimit të bordit të ERE nr. 139, datë 15.08.2016 ”*Rregullat e përkohshme të tregut Shqipëtar të Energjisë Elektrike*” e cila nuk mundësonte kompensimin e saktë të disbalancave si për KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., pasi , disbalanca pozitive e OSHEE sh.a., nuk paraqet injektim shtesë (mbi nominim) në rrjet, por paraqet thjesht diferencën e programit (nominimit) me realizimin, matje e energjisë të pashoqëruar me injektim fizik të energjisë në rrjet.
- OST sh.a., jo vetëm ka evidentuar situatën në fjalë, por ka propozuar dhe një mënyrë për zgjidhjen e saj, duke propozuar ndryshimet përkatëse të cilat do të shmangin situatën e krijuar dhe duke parashtruar këtë zgjidhje me fakte përkatëse. Këtë qëndrim e ka sqaruar dhe mbajtur gjithashtu në të gjitha seancat dëgjimore të kryera lidhur me këtë problematikë. Për gjithë sa më sipër shoqëria OST sh.a. ka dërguar tabelat ilustruese për disbalancat e subjektit OSHEE sh.a., në rastin kur ka programin e HEC –eve në transmetim dhe rasti i disbalancave që shkakton OSHEE sh.a., kur nuk e ka programin e HEC –eve. Në këtë tabelë evidentohen disbalancat artificiale pozitive, që realisht OSHEE sh.a., nuk ka injektuar fizikisht energji në rrjet për këto orë që janë ilustruar në tabelë duke i krijuar KESH sh.a diferenca në bilancin financiar.“OSHEE” sh.a, nuk ka krijuar disbalanca pozitive ajo realisht krijon disbalanca negative dhe ka pasur detyrimin që këto disbalanca t’ia paguajë KESH sh.a.
- Nga ana tjetër, shoqëria KESH sh.a në korrespondencën e nisur me e – mail, protokolluar në ERE me nr. 114/7 Prot, datë 21.03.2018, ka paraqitur shkresën e shoqërisë OST sh.a, lidhur me “*Mbylljen e bilancit të subjektit KESH sh.a*”. Ndër të tjera në këtë shkresë kompania “OST” sh.a citon se:
 - “OST” sh.a, duke nisur nga muaji korrik 2016 dhe për gjithë vitin 2017 deri në hyrjen në fuqi të “*Rregullave të Përkoheshme të Mekanizmit Balancues*”, shoqëria KESH sh.a., ka patur probleme me bilancin financiar si pasojë e menyrës së llogaritjes së disbalancave bazuar në “*Rregullat e Përkoheshme të Tregut të Energjisë Elektrike*”. Lidhur me diferencat që KESH sh.a, ka në bilancin e saj financiar përse i përket periudhës korrik

2016 dhe për gjithë vitin 2017, shkaktar i kësaj situatë janë disbalancat e shkaktuara nga subjekti OSHEE sh.a.

- Në datën 19.03.2018, ERE organizoi një seancë degjimore pranë zyrave të saj, mes përfaqësuesve të shoqërisë OST sh.a dhe KESH sh.a.
- **Gjatë seancës palët parashtruan:**
 - *OST sh.a, pranoi se, KESH sh.a, nuk ishte kompensuar në mënyrën e duhur dhe kompania OST sh.a, kërkoi rishikimin e faturave në mënyrë që dhe kompania KESH sha, të mbyllë bilacent e saj.*
 - KESH sh.a, në seancë shprehu dakordësinë e saj lidhur me këtë korrigjimin e faturave, gjë që do t'i jepte mundësinë KESH sh.a, të shmangte gjobën nga tatimet për vitin 2016.
- Të dyja palët kërkuan nga ERE vendimarrje në mënyrë që “OST” sh.a, të ketë mundësi të rishikojë faturat e energjisë elektrike dhe t'ua nisë palëve (KESH sh.a dhe OSHEE sh.a), faturat e rishikuara në mënyrë që të shmangen diferencat në bilancin energjistik dhe financiar të KESH sh.a, për shërbimet e balancimit.
- Në vijim materiali i përgatitur nga Drejtoritë Teknike, u paraqit për shtyrzim në Bord, në mbledhjen e datës 19.04.2018. Gjatë zhvillimit të mbledhjes u gjykua që të shtyhej vendimmarrja në mënyrë që të zhvillohej një takim konsultativ me tre shoqëritë që do të preken nga korigjimi i faturave.
- Me shkresën e saj nr. 330 Prot, datë 23.04.2018, ERE njoftoi KESH sh.a; OST sh.a dhe OSHEE sh.a, lidhur me zhvillimin e takimit konsultativ.
- Në datën 24.04.2018, u zhvillua takimi me prezencën e përfaqësuesve të ERE, KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE sh.a. Gjatë takimit nga ana e OST sh.a u deklarua se;
 - Faturat e lëshuara nga OST sh.a për disbalancat janë firmosur dhe pranuar nga të dyja palët;
 - Problematika e disbalancave shtrihet në periudhën 1 korrik 2016 - dhjetor 2017 pikërisht në periudhën kur OSHEE sh.a është bërë palë përgjegjëse për balancim në bazë të ligjit;
 - Problematika e shkaktuar vjen nga Prodhuesit me Përparësi të Energjisë të lidhur në rrjetin e transmetimit dhe atë të shpërndarjes të cilët nuk janë subjekt i disbalancave, por të gjithë energjinë e prodhuar kanë të drejtë t'ua shesin tek OSHEE dhe tashmë janë zhveshur nga llogaritjet për të cilat OSHEE sh.a nuk ka të dhëna në frekuencat kohore që përkojnë me nominimet dhe komponentet që nevojiten për zbatimin e mekanizmit llogaritës të disbalancave, ndërkohë kjo disbalancë pozitive është e pasqyruar vetëm në fatura dhe nuk është energji e prodhuar apo e livruar në rrjet;
 - Propozimi për ndryshimin e mekanizmit llogarites së disbalancave është paraqitur nga OST sh.a në ERE në tetor 2016, por duke që se komponentët që nevojiteshin për zbatimin e këtij mekanizmi ishin dhe PPE (të cilat Ligji nr. 138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme” dhe më pas Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, neni 22, pika 5, i përjashton nga detyrimi për kostot e disbalancave të

shkaktuara deri në 31 dhjetor 2022.), si dhe HEC Ashta i cili trajtohet me marrëveshje të veçantë PPA, e cila trajton përgjegjësinë për balancim në mënyrë specifike si Ligji për Energjitikë e rinovueshme; Rregullat e tregut dhe të balancimit në atë kohë ishin në proces amendimi, si dhe jo të gjitha palët shprehën dakortësinë për këtë propozim të OST sh.a, u vendos që kjo e fundit të vijonte trajtimin e disbalancave sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi në atë kohë deri me amendimin e këtyre akteve;

- Impakti financiar që do të vijë nga korigjimi i faturave do të reflektohet tek OSHEE sh.a;
 - Korigjimi nuk do të ketë impakt në bilancin energjistik i cili bazohet në matje, ndërsa disbalancat nuk janë fluks energjie pasi është vetëm programim. Dhe tek OSHEE sh.a do të reflektohet vetëm si vlerë dhe afektohet vetëm bilanci financiar.
 - Korigjimi i faturave do të bëhet muaj për muaj për të dy kompanitë.
 - Llogaritja e disbalancave duhej bërë me programimin dhe matjen e KESH sh.a që në fillim.
 - Mekanizmi i llogaritjes ka qenë dhe është i rregullt, por ndryshon vetëm mënyra e programit të përdorur.
 - KESH sh.a. ngre problematiken që thelbi i mosmarrëveshjes është mos respektimi i kontratës nga ana e OSTsh.a..
 - Ndersa OSHEE shprehet se do të respektojë mekanizmin balancues që ka qenë në atë kohë siç po respekton të tanishmin.
- Në vijim të detyrave të lëna në seancën dëgjimore, OST sh.a dërgoi me e – mail në ERE, në datën 26.04.2018 llogaritjet e një muaji si shembull për përlllogaritjet që do ndiqen në vijim për gjithë periudhën e kërkuar për t’u korigjuar faturat.
 - Sa sipërcituar si dhe nga analizimi i të dhënave dërguar nga OST sh.a si dhe i deklarimeve të bëra në seancat dëgjimore, nga drejtoritë teknike të ERE-s evidentohet se problematika e krijuar vjen si efekt i mekanizmit balancues gjithëpërfshirës si dhe programimit të OSHEE sh.a i cili përfshinte në tërësinë e tij edhe subjekte të cilat nuk janë palë përgjegjëse për balancimin, duke shkaktuar kështu të dhëna virtuale, që afektojnë artificialisht vlerën e disbalancës pozitive gjatë zbatimit nga OST sh.a të mekanizmit të mëparshëm për llogaritjen e disbalancave midis palëve KESH sh.a – OSHEE sh.a.
 - Gjithashtu gjatë shqyrtimit të kësaj problematike, nga ERE u konstatua edhe vullneti i përbashkët i palëve KESH sh.a dhe OST sh.a për korigjimin e këtyre faturave.
 - Nga informacionet e detajuara të dërguara nga palët pranë ERE, vërehet se duke aplikuar në mekanizmin e përlllogaritjes së disbalancave, vlerat e marra nga matja siç porpozuar nga OST sh.a, sjellin një zbatim më korrekt të Metodologjisë dhe nuk çojnë në diferenca të mëdha për vlerat e përlllogaritjes së disbalancave nga palët.
 - Rregullat e Përkohëshme të Tregut, përcaktojnë në Kapitullin XI.2.3:
 - Në rast mosmarrëveshje, pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë shumën
 - korresponduese në përputhje me udhëzimet për nxjerrjen e faturave të nxjerrë nga OSTja; mosmarrëveshja nuk vonon ekzekutimin e detyrimeve. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, do të bëhet korigjimi i faturës, po të jetë e nevojshme.

- Kapitulli II, pika 2.4
 - OST-janë funksionin e saj si operator tregu, kryen operimin e tregut të energjisë elektrike.
 - Operatori i tregut ... *“do të jetë përgjegjës për organizimin dhe administrimin e likuidimeve dhe pagesave të energjisë elektrike mes pjesëmarrësve të tregut për tregun balancues”*;
- Gjithashtu ERE në praktikat e mëparshme, kur është konstatuar zbatim jo i drejtë i rregulloreve dhe akteve të saj përkatëse, i ka mundur palëve korigjime të faturave duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shoqëria “OST” sh.a, në çdo rast të bëjë korigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përlllogaritjeve nga OST sh.a të rakorduara dhe të pranuar nga palët përgjegjëse për periudhen 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2017.
2. Të informohet ERE për rezultatet e arritura në zbatim të këtij vendimi.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.